



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.294, datë 19.09.2023

PËR

**“VERIFIKIMIN E KANDIDATËVE PËR PLOTËSIMIN E KUSHTEVE  
LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR PROCEDURËN E TRANSFERIMIT  
NËPËRMJET LËVIZJES PARALELE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN  
NR.285, DATË 17.07.2023 TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË”**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 43 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 9 dhe 15 të Rregullores “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” të ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës së kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore të kandidimit për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, për 2 ( dy) vende vakante në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, sipas aneksit Nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Caktimin me short të zonjës Eloida Goxhi si relatore për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për pozicionin vakant Nr.1 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallur me vendimin Nr.285, datë 17.07.2023 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
3. Caktimin me short të zotit Bujar Sheshi si relator për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për pozicionin vakant Nr.2 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallur me vendimin Nr.285, datë 17.07.2023 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
4. Relacioni i Komisionit për Zhvillimin e Karrierës është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Të njoftojë të gjithë kandidatët për këtë vendim.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dita e njoftimit të vendimit.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

8. U shpall në Tiranë, sot më 19.09.2023.



### KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETAR**  
Alfred Balla

**ANËTAR**  
Sokol Stojani

**ANËTAR**  
Eloida Goxhi

**ANËTAR**  
Arta Mandro

**ANËTAR**  
Bujar Sheshi

**ANËTAR**  
Esmeralda Keshi

**ZV/KRYETAR**  
Tartar Bazaj

**ANËTAR**  
Nurithan Seiti

**ANËTAR**  
Zeqir Hoda

**ANËTAR**  
Ledina Riza



ANEKS Nr.1

**Lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore të kandidimit për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, për 2 ( dy) vende vakante në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë:**

1. **Blerta Hamza**, *Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;*
2. **Enkeleda Hoxha**, *Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës;*
3. **Erida Visoçi**, *Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë;*
4. **Ervisa Hyka**, *Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;*
5. **Gentian Habazaj**, *Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;*
6. **Gëzim Veizi**, *Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;*
7. **Neritan Hoxha**, *Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;*
8. **Riselda Fishta**, *Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;*
9. **Vitjuna Mata**, *Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë;*

